„Предизвиците во фискалната децентрализација постојат од самиот почеток на имплементирањето на децентрализацијата во земјава и не се разрешени во изминативе тринаесет години. Огромни долгови, блокирани општински сметки, недостаток на средства за спроведување на префрлените надлежности, незначително зафаќање од ДДВ од персоналниот данок за потребите на локалната власт е реалноста со која се соочуваат општините и која е сериозен предизвик во обезбедувањето на квалитетни услови за живот и квалитетни услуги за граѓаните. Затоа можеби треба поинтензивно да размислуваме за сосема нов концепт на организирање и на финансирање на локалната самоуправа. ЗЕЛС веќе има направено и одредени предлози што се утврдени во Систематизирани ставови, кои се испратени и до Владата на Република Македонија и до Министерството за финансии" . Ова го истакна претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, на тркалезната маса „Предизвиците во системот на финансирање на надлежностите на општините- редефинирање на начинот и утврдување на критериумите за наменски и блок дотации за општините", што го организираше Министерството за локална самоуправа, на 1 ноември 2018 година, во Скопје. Претседателот на ЗЕЛС нагласи дека според првичната анализа што во 2005 година ја направи ЗЕЛС, општините наследија основен долг од 51 милион евра. Министерството за финансии, неодамна излезе со податок дека вкупниот општински основен долг изнесува околу 100 милиони евра. Тој посочи дека недостаток на финансиски средства има во речиси сите надлежности на општините, а причините се многу јасни. Особено е алармантна состојбата во образованието, каде со години се занемаруваат реалните поскапувања на реагенсите, се воведуваат дополнителни обврски за општините, како што е бесплатниот превоз на учениците, се зголемуваат платите на наставниците, а при тоа средствата во блок дотациите соодветно не се надополнуваат. Згора на тоа, во 2010 година, општините не ја добија дванаесеттата рата од блок дотацијата за образование. Со јавните набавки за обезбедување на бесплатен превоз на ученици, наместо пониски, се обезбедуваа нереално високи цени. За среќа, дел од овој проблем ќе се надмине со последните измени во Законот за превоз во патниот сообраќај, усвоен од Собранието на Република Македонија, но повторно

## A NEVOJITET NJË KONCEPT I RI PËR ORGANIZIMIN DHE FINANCIMIN E VETËQEVERISJES LOKALE?

"Sfidat në decentralizimin fiskal ekzistojnë që nga fillimi i implementimit të decentralizimit në vend dhe nuk janë zgjidhur në trembëdhjetë vitet e kaluara. Borxhe shumë të mëdha, llogari të bllokuara komunale, mungesë e mjeteve për zbatimin e kompetencave të transferuara, përfshirje e ulët e TVSH-së, e tatimit personal për nevojat e pushtetit lokal është realiteti me të cilin ballafaqohen komunat dhe i cili është një sfidë serioze në sigurimin e kushteve cilësore të jetesës dhe shërbimeve cilësore për qytetarët. Prandaj ndoshta duhet të mendojmë në mënyrë më intensive për një koncept krejtësisht të ri të organizimit dhe të financimit të vetëqeverisjes lokale. BNJVL-ja tashmë ka bërë edhe propozime të caktuara të cilat janë të përcaktuara në Qëndrimet e sistematizuara, të cilat janë dërguar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë dhe në Ministrinë e Financave".

Këtë e theksoi kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov në tryezën e rrumbullakët "Sfidat në sistemin e financimit të kompetencave të komunave - ridefinimi i mënyrës dhe përcaktimi i kritereve për bllok dotacionet dhe dotacionet me dedikim për komunat", që e organizoi Ministria e Vetëqeverisjes Lokale më 01 nëntor 2018, në Shkup.

Kryetari i BNJVL-së theksoi se sipas analizës fillestare të cilën e bëri BNJVL-ja në vitin 2005, komunat trashëguan një borxh bazë prej 51 milion eurosh. Ministria e Financave kohët e fundit doli me një të dhënë se borxhi i përgjithshëm bazë komunal është rreth 100 milionë eurosh. Ai theksoi se ka mungesë të mjeteve financiare pothuajse në të gjitha kompetencat e komunave, ndërsa arsyet janë shumë të qarta. Veçanërisht është alarmante situata në arsim, ku me vite të tëra lihen pas dore rritjet reale të çmimeve të reagjensëve, aplikohen përgjegjësi shtesë për komunat, siç është transporti falas i nxënësve, rriten rrogat e mësuesve, e në të njëjtën kohë mjetet e bllok-dotacioneve nuk plotësohen në mënyrë adekuate. Përveç kësaj, në vitin 2010 komunat nuk morën këstin e dymbëdhjetë të bllok-dotacionit për arsim. Me prokurimet publike për sigurimin e transportit falas të nxënësve, në vend se të siguroheshin çmime më të ulëta, siguroheshin çmime më te larta joreale. Për fat të mirë një pjesë e këtij problemi do të tejkalohet me ndryshimet e fundit të Ligjit për transport në komunikacionin rrugor, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, por përsëri e gjithë kjo nuk është e mjaftueshme për



сето тоа не е доволно за подобрување на состојбите. Во детските градинки и во противпожарните служби, не се дозволуваше пополнување на местата на вработените кои заминуваа во пензија, па општините од сопствени средства го надополнуваа овој кадар, а воопшто не е подобра и состојбата во културата, каде егзистираат институции во лоша состојба и со само еден вработен. Во последната година, во договор со Владата се реши дел од овој проблем и поредовно се добиваат согласности за вработувања. Кај противпожарните единици проблемот е поврзан со застарена опрема, возила, униформи за пожарникарите и недоволно вработени. На тркалезната маса на која што присуствуваа градоначалници, претставници од министерствата и од експертската јавност, беа презентирани и дискутирани наодите од анализата направена во консултација со надлежните министерства и со општините за начинот на финансирање на надлежностите на општините во областите на основното и средното образование, детските градинки, културата и противпожарната заштита, финансирани со блок дотации од централниот буџет. Свои обраќања имаа и министерот за локална самоуправа, Сухејл Фазлиу, министерот за образование, Арбер Адеми, министерот за култура, Асаф Адеми и Јова Тренчевска, државен секретар во Министерството за труд и социјална политика. Министерот Фазлиу истакна дека Владата смета дека на општините им е потребна итна финансиска поддршка, особено за исплаќање на заостанатите долгови, но, исто така, дека се неопходни системски мерки за да не се продуцираат нови долгови во иднина. Првата мерка се однесува на донесувањето на Законот за пријавување и евиденција на обврските на сите корисници на јавни средства, врз основа на што беше направена и проекцијата на Владата за вкупниот долг. Втората е усвојувањето на Предлог-закон за финансиска поддршка на општините и измените на Законот за финансирање на единиците на локалната самоуправа. Праксата на нереално планирање на буџетот и преземање на обврски без покритие треба да заврши. Третата мерка е системска и е насочена кон преиспитување на начинот на финансирање на надлежностите на општините во областа на образованието, детските градинки, локалните установи од областа на културата и противпожарната заштита.

## АКТИВНОСТИТЕ НА ЗЕЛС ЗА РОДОВО ОДГОВОРНИ ОПШТИНИ, ДОБАР ПРИМЕР ЗА НЕВЛАДИНИОТ СЕКТОР ОД АЛБАНИЈА И МОЛДАВИЈА

Околу триесетина претставници од Република Албанија и од Република Молдавија, кои работат на полето на родовата еднаквост во нивните земји, на 7 ноември 2018 година, дојдоа во ЗЕЛС да се запознаат со активностите на Асоцијацијата во оваа област. Посетата беше реализирана во рамките на дводневниот престој на овие две делегации во нашата земја, поддржан од UN Women – тело на ОН за родова еднаквост и зајакнување на жените, со кое во изминатите неколку години, активно соработува и ЗЕЛС .

Присутните најпрво беа информирани за улогата, структурата и активностите на ЗЕЛС, како единствена национална асоцијација на сите единици на локална власт во Република Македонија, која ги застапува своите членки и лобира пред централната власт за обезбедување на поадекватна законска регулатива за квалитетно

përmirësimin e gjendjeve. Në kopshtet e fëmijëve dhe në shërbimet e zjarrfikësve, nuk lejohej plotësimi i vendeve të punonjësve që kanë shkuar në pension, kështu që komunat me mjetet e veta plotësonin këto kuadro, e aspak nuk është më e mirë edhe gjendja në kulturë, ku institucionet ekzistojnë në gjendje të keqe dhe vetëm me një punonjës. Në vitin e fundit, në marrëveshje me Qeverinë u zgjodh një pjesë e këtij problemi dhe më rregullisht merren pajtueshmëri për punësime. Te njësitë e zjarrfikësve problemi ka të bëjë me pajisjet e vjetërsuara, automjetet, uniformat për zjarrfikësit dhe kuadri i pakët i punësuar. Në tryezën e rrumbullakët, në të cilën morën pjesë kryetarë të komunave, përfaqësues të ministrive dhe ekspertë, u prezantuan dhe diskutuan gjetjet e analizës së bërë në konsultim me ministritë përkatëse dhe me komunat për mënyrën e financimit të kompetencave të komunave në fushat e arsimit fillor dhe të mesëm, kopshteve të fëmijëve, kulturës dhe mbrojtjes nga zjarri, të financuara me bllok-dotacione nga buxheti qendror. Fjalime të tyre patën edhe Ministri i Vetëqeverisjes Lokale, Suhejl Fazliu, Ministri i Arsimit, Arbër Ademi, Ministri i Kulturës, Asaf Ademi dhe Jova Trençevska, sekretari shtetëror në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale.

Ministri Fazliu theksoi se Qeveria konsideron se komunat kanë nevojë për mbështetje urgjente financiare, veçanërisht për pagimin e borxheve të mbetura. Por, gjithashtu janë të nevojshme edhe masa sistematike për të mos krijuar borxhe të reja në të ardhmen. Masa e parë ka të bëjë me miratimin e Ligjit për raportimin dhe evidentimin e obligimeve të të gjithë përdoruesve të mjeteve publike, në bazë të të cilave është bërë edhe projektimi i Qeverisë për borxhin total. Masa e dytë është miratimi i një projektligji për mbështetjen financiare të komunave dhe ndryshimet në Ligjin për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale. Duhet të përfundojë praktika e planifikimit joreal të buxhetit dhe ndërmarrja e obligimeve pa mbulim. Masa e tretë është sistematike dhe ka për qëllim rishqyrtimin e mënyrës së financimit të kompetencave të komunave në fushën e arsimit, kopshteve të fëmijëve, institucioneve lokale të fushës së kulturës dhe mbrojtjes nga zjarri.

## AKTIVITETET E BNJVL-së PËR KOMUNA PËRGJEGJËSE PËR BARAZI GJINORE, SHEMBULL I MIRË PËR SEKTORIN JOQEVERITAR NË SHQIPËRI DHE MOLDAVI

Rreth tridhjetë përfaqësues nga Republika e Shqipërisë dhe Republika e Moldavisë, të cilët punojnë në fushën e barazisë gjinore në vendet e tyre, më 7 nëntor 2018, vizituan BNJVL-në që të informohen për aktivitetet e Asociacionit në këtë lëmi. Vizita u realizua në kudër të qëndrimit dyditor të këtyre dy delegacioneve në vendin tonë, të përkrahur nga UN Women – trupi i KB-së për barazi gjinore dhe përforcim të rolit të femrës, me të cilin në gjatë viteve të kaluara bashkëpunon në mënyrë aktive edhe BNJVL-ja.

Të pranishmit fillimisht u informuan me rolin, strukturën dhe aktivitetet e BNJVL-së, si asociacion i vetëm nacional i të gjitha njësive të pushtetit lokal në Republikën e Maqedonisë, që i përfaqëson anëtaret e saja dhe lobon para pushtetit qendror për sigurimin e rregullativës më adekuate ligjore për zba-

спроведување на префрлените надлежности на локално ниво. Од презентацијата за проектот „Зајакнување на капацитетите на општинските службеници и локални претставници за родово одговорно буџетирање", што го реализира ЗЕЛС, со поддршка на UN Women, присутните се запознаа со видот на поддршката што ЗЕЛС им ја дава на своите членки. Беше посочено дека во 2017/18 се реализирани обуки на општинските координатори за родова еднаквост и на дел од советниците, членови на комисиите за родова еднаквост во општините, односно обучени се вкупно 65 лица од локалната власт. Реализирани се и обуки за обучувачи. Формирана е работна група при ЗЕЛС, од десетина општински координатори за родова еднаквост ( која е отворена за нови заинтересирани членови) каде меѓусебно се разменуваат искуства во насока на поголема и поквалитетна примена на законските обврски, но и на развивање на сопствени идеи за активности на ова поле во општините. Развиена е соработка со надлежни институции во земјава, особено со Министерството за труд и социјална политика, но и со странски асоцијации од оваа област. Зголемен е бројот на општини кои ја прифатија и потпишаа Европската повелба за родова еднаквост, чиј број сега изнесува 20 општини од нашата земја. Изработена е Стратегија за родова еднаквост на ЗЕЛС за 2018-2030 година со Акциски план, каде се утврдени натамошните чекори што ќе ги презеде ЗЕЛС за своите членки, на полето на имплементирање и развивање на родовите политики на локално ниво.

Како посебен успех во досегашниот период беше наведена прифатената иницијата, упатена до Министерството за финансии, да се стави посебна ставка во буџетскиот циркулар за родова еднаквост, како и активното учество на претставник од ЗЕЛС во Интер-ресорската работна група при МТСП за родова еднаквост, каде се застапуваат интересите на општините.

tim cilësor të kompetencave të transferuara në nivel lokal. Nga prezantimi i projektit „Përforcim i kapaciteteve të nëpunësve komunalë dhe përfaqësuesve lokalë për buxhetim përgjegjës për barazi gjinore", që e realizon BNJVL-ja me përkrahjen e UN Women, të pranishmit u njoftuan për llojin e përkrahjes të cilën ua jep BNJVL-ja anëtareve të saja. U përmend se në vitin 2017/18 janë realizuar trajnime të koordinatorëve komunalë për barazi gjinore edhe të një pjese të këshilltarëve, anëtarëve të komisioneve për barazi gjinore në komunat, respektivisht janë trajnuar gjithsej 65 persona nga pushteti lokal. Janë realizuar trajnime edhe për trajnuesit. Është formuar një grup punues në kuadër të BNJVL-së, nga dhjetë koordinatorë për barazi gjinore (i cili është i hapur për anëtarë të rinj të interesuar) ku shkëmbehen përvoja të ndërsjella në drejtim të zbatimit më të madh dhe më cilësor të obligimeve ligjore, por edhe të zhvillimit të ideve personale për aktivitetet në këtë lëmi nëpër komuna. Është zhvilluar një bashkëpunim me institucionet kompetente në vend, veçanërisht me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, por edhe me asociacionet e huaja në këtë lëmi. Është rritur numri i komunave të cilat pranuan dhe firmosën Kartën Evropiane për barazi gjinore, numri i të cilave tani është 20 komuna nga vendi ynë. U hartua edhe Strategjia për barazi gjinore të BNJVL-së për vitin 2018-2030 me Plan aksional ku janë përcaktuar hapat e mëtejmë që do t'i ndërmarrë BNJVL-ja për anëtaret e saja, në fushën e implementimit dhe zhvillimit të politikave për barazi gjinore në nivel lokal.

Si sukses i veçantë në periudhën e deritanishme u përmend iniciativa e pranuar, e dërguar në Ministrinë e Financave, të vendoset një pikë e veçantë në cirkularin buxhetor për barazi gjinore, si dhe pjesëmarrja aktive e përfaqësuesit të BNJVL-së në Grupin punues ndër-resorik në kuadër të MPPS-së për barazi gjinore, ku përfaqësohen interesat e komunave.



### Електронската платформа за родово одговорно буџетирање (www.rob.zels.org.mk)

На презентацијата беше претставена електронската платформа за родово одговорно буџетирање (www. rob.zels.org.mk), што ја обезбеди ЗЕЛС со сопствени капацитети и ја одржува за своите членки. Оваа „е-платформа" е единствена во регионот, на која може да се најдат сите информации и документи, поврзани со родово одговорно буџетирање и родовата еднаквост од општините, а поставена е и интерактивна мапа со статистички податоци, како и постигнати резултати на поуспешните општини на ова поле. Платформата содржи и дигитална библиотека со планови и програми од општините, како и можност за интерактивна размена на мислења и ставови меѓу координаторите и членовите на комисиите.

Триесетчлената делегација на 8 ноември 2018 година ги посети и општините: Кочани, Штип и Свети Николе, каде се сретнаа со градоначалниците, координаторите и членовите на комисиите за родова еднаквост, се запознаа со нивните активности и се стекнаа со нови, позитивни искуства што може да ги применат при спроведувањето на активностите во своите земји.

### Platforma elektronike për buxhetim të përgjegjshëm gjinor (www.rob.zels.org.mk)

Në prezantimin në fjalë, u prezantua platforma elektronike për buxhetim përgjegjës për barazi gjinore (www.rob.zels.org.mk), të cilën e siguroi BNJVL-ja me kapacitete personale dhe e zbaton për anëtaret e saja. Kjo „e-platformë" është e vetmja në rajon, në të cilën mund të gjenden të gjitha informacionet dhe dokumentet lidhur me buxhetimin përgjegjës për barazi gjinore nga komunat, ndërsa është vendosur edhe harta interaktive me të dhëna statistikore, si dhe rezultatet e arritura të komunave më të suksesshme në këtë fushë. Platforma përmban edhe bibliotekën digjitale me planet dhe programet e komunave si dhe mundësia për shkëmbim interaktiv të mendimeve dhe qëndrimeve midis koordinatorëve dhe anëtarëve të komisioneve.

Delegacioni i përbërë nga tridhjetë anëtarë më 8 nëntor 2018 vizitoi edhe komunat: Koçan, Shtip dhe Sveti Nikole, ku u takuan me kryetarët e komunave, koordinatorët dhe anëtarët e komisioneve, u informuan për aktivitetet e tyre dhe fituan përvoja të reja, pozitive që mund t'i zbatojnë gjatë zbatimit të aktiviteteve në vendet e tyre.

## "10 ОСНОВНИ ПРИДОБИВКИ ОД ОДРЖЛИВА УРБАНА МОБИЛНОСТ"

- ПОДОБРУВАЊЕ НА КВАЛИТЕТОТ НА ЖИВОТОТ
- НАМАЛУВАЊЕ НА ТРОШОЦИ И СОЗДАВАЊЕ НА ЕКОНОМСКИ РАЗВОЈ
- ПРИДОНЕС КОН ПОДОБРО ЗДРАВЈЕ И ЖИВОТНА СРЕДИНА
- НЕПРЕЧЕНА МОБИЛНОСТ И ПОДОБРУВАЊЕ НА ПРИСТАПОТ
- ПОЕФИКАСНО КОРИСТЕЊЕ НА ОГРАНИЧЕНИ РЕСУРСИ
- ОСВОЈУВАЊЕ НА ЈАВНАТА ПОДДРШКА
- ПОДГОТОВКА НА ПОДОБРИ ПЛАНОВИ - НАСОЧЕНИ КОН ЛУЃЕТО
- ЕФЕКТИВНО ИСПОЛНУВАЊЕ НА ЗАКОНСКАТА ОБВРСКА
- КОРИСТЕЊЕ НА СИНЕРГИЈА, ЗГОЛЕМУВАЊЕ НА ВАЖНОСТА
- СОЗДАВАЊЕ НОВА КУЛТУРА ЗА МОБИЛНОСТ

## "10 PËRFITIME THEMELORE TË MOBILIZIMIT TË QËNDRUESHËM URBAN"

- PËRMIRËSIM TË CILËSISË SË JETËS
- ZVOGLIM TË SHPENZIMEVE DHE ZHVILLIM EKONOMIK
- PËRFITIME PËR SHËNDET DHE MJEDISIN JETSOR MË TË MIRË
- MOBILIZIM TË PANDËRPRERË DHE PËRMIRËSIM TË QASJES
- PËRDORIM MË EFIKAS TË BURIMEVE TË KUFIZUARA
- FITIM TË PËRKRAHJES PUBLIKE
- PËRGATITJE TË PLANEVE MË TË MIRA – TË ORIENTUAR DREJT NJERËZVE
- ZBATIM EFEKTIV TË KOMPETENCAVE LIGJORE
- PËRDORIM TË SINERGJISË, RRITJE TË RËNDËSISË
- KRIJIM TË KULTURËS SË RE PËR MOBILIZIM

Повеќе информации можете да најдете на страницата на ЗЕЛС:

Informacione plotësuese mund të gjenden në ueb faqen zyrtare të BNJVL-së:

**www.zels.org.mk**

## ГРАДЕЖНИТЕ ИНСПЕКТОРИ ОД ОПШТИНИТЕ ИЗНЕСОА НИЗА ПРЕДЛОЗИ ЗА ЗАКОНОТ ЗА ГРАДЕЊЕ

Околу четириесетина овластени градежни инспектори од општините дојдоа на работилницата што ја организираше ЗЕЛС, на 9 ноември 2018 година. Присутните имаа можност да дискутираат со претставници од Државниот градежен инспекторат, при Министерството за транспорт и врски, за актуелните теми со кои се соочуваат при спроведувањето на постапките при инспекцискиот надзор. Исто така, тие имаа можност да искажат и забелешки и предлози за новиот Закон за градење, што е во фаза на подготвување.

На работилницата се дискутираше за имплементацијата на одредени одредби од прекршочната постапка, од постапката за административно извршување и постапка за поднесување на кривична пријава. Беше изнесена дилемата како треба да се постапи кога одредена градба, од страна на овластениот градежен инспектор, ќе биде отстранета, а потоа во второстепена постапка или судска постапка предметот се поништува и се враќа на повторно постапување. Стана збор и за одредбата 129 од Законот за градење, каде е посочено дека овластен градежен инспектор е службено лице кое е самостојно во вршење на инспекцискиот надзор (контрола на лице место, водење управна постапка и извршување). Присутните истакнаа дека инспекциската постапка е тимска работа и поради сложеноста потребно е инспекторот, како стручно лице, да го изготви записникот, додека управната постапка (решенијата) треба да ја изготвува правник, како чисто правна материја, а извршувањето на решенијата да го спроведува извршна служба. По дискусијата, градежниот инспектор од Државниот градежен инспекторат при Министерството за транспорт и врски, Костел Шекутковски, ги нотираше предлозите и забелешките на присутните и истите ќе ги предложи на разгледување на подносителите на Законот за градење. Беа изнесени следниве забелешки:

## INSPEKTORËT KOMUNALË TË NDËRTIMIT ME NJË SËRË PROPOZIMESH PËR LIGJIN PËR NDËRTIM

Rreth 40 inspektorë të autorizuar ndërtimorë nga komunat morën pjesë në punëtorinë e organizuar nga BNJVL-ja më 9 nëntor 2018. Pjesëmarrësit patën mundësinë të diskutojnë me përfaqësuesit e Inspektoratit Ndërtimor Shtetëror pranë Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, për temat aktuale me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit të procedurave gjatë mbikëqyrjes inspektuese. Ata gjithashtu patën mundësinë të shprehin vërejtjet dhe propozimet e tyre për Ligjin e ri për ndërtim, i cili është në fazën e përgatitjes.

Në punëtori u diskutua për zbatimin e dispozitave të caktuara të procedurës kundërvajtëse, procedurës për zbatimin administrativ dhe procedurës për ngritjen e kallëzimeve penale. U theksua dilema se si duhet të veprohet, kur një ndërtim i caktuar do të hiqet nga ana e inspektorit të autorizuar ndërtimor, e pastaj në procedurën e shkallës së dytë ose në procedurën gjyqësore anulohet dhe kthehet për rishqyrtim. U bë fjalë edhe për nenin 129 të Ligjit për ndërtim, ku thuhet se inspektori i autorizuar ndërtimor është person zyrtar i cili është i pavarur në kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese (inspektimi në vendin e ndërtimit, zhvillimi i procedurës administrative dhe procedurës së ekzekutimit). Pjesëmarrësit theksuan se procedura e inspektimit është një punë ekipore dhe për shkak të kompleksitetit është e nevojshme që inspektori si ekspert ta përgatisë procesverbalin, ndërsa procedurën administrative (vendimet) duhet ta përgatisë një jurist, si një çështje krejtësisht ligjore, ndërsa ekzekutimin e vendimeve ta kryejë shërbimi komunal për ekzekutim. Pas diskutimit, inspektori ndërtimor nga Inspektorati Ndërtimor Shtetëror pranë Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, Kostell Shekutkovski, shënoi propozimet dhe vërejtjet e pjesëmarrësve dhe të njëjtat do t'ua propozojë për shqyrtim parashtruesve të Ligjit për ndërtim. U nxorën vërejtjet e mëposhtme:



**1.** Градежната инспекциска постапка е тимска работа и треба да вклучува градежен инспектор, правник и извршител;
**2.** Роковите за извршување да бидат во интервал од 24 часа, а не во временски период од 08-20 часот, како што е во актуелната постапка и тоа да се однесува за само еден објект;
**3.** Да се дефинира конкретно што се подразбира под градежен објект и што е предмет на рушење на градежен објект, да се направи класификација, така што дел од објектите би можеле да бидат покриени и од комуналната инспекција;
**4.** Да се врати извршувањето на постапката за рушење кај извршителите, а не кај градежните инспектори;
**5.** Градежните инспектори да не бидат подносители на пријава за одземање на имот, туку тоа да биде општината. Одговорноста да биде поделена со градоначалникот, бидејќи инспекторите се соочуваат со многу судски спорови;
**6.** Градежните инспектори да бидат повторно централизирани, со цел поефикасно вршење на нивната работа, но и заради намалување на ризиците од секојдневни закани, навреди, омаловажувања, па и физички напади, со кои се соочуваат во своите општини;
**7.** Да се стимулира работата на инспекторите и да се одреди колку инспектори се потребни според бројот на жители во општината, бидејќи сега тој број е мал, а предметите се бројни;
**8.** Да се утврди до каде е изготвувањето на Правилникот за надоместок при ризик од работа, кој требаше да го изработи Инспекцискиот совет.

**1.** Procedura inspektuese ndërtimore është një punë ekipore dhe duhet të përfshijë një inspektor të ndërtimit, një jurist dhe një përmbarues;
**2.** Afatet për ekzekutim të jenë në intervalin prej 24 orësh, e jo në periudhën kohore prej orës 08 deri në orën 20, siç është në procedurën aktuale dhe kjo të vlejë vetëm për një objekt;
**3.** Të definohet konkretisht se çfarë nënkuptohet me termin "objekti i ndërtimit" dhe çfarë është objekti i rrënimit të objektit ndërtimor, të bëhet një klasifikim, kështu që pjesa e objekteve do të mund të mbuloheshin edhe nga inspektimi komunal;
**4.** Të kthehet ekzekutimi i procedurës së rrënimit te përmbaruesit, e jo te inspektorët e ndërtimit;
**5.** Inspektorët e ndërtimit të mos jenë parashtrues të fletëparaqitjes për konfiskimin e pronës, por ajo të jetë komuna; Përgjegjësia të ndahet me kryetarin e komunës, sepse ballafaqohen me shumë konteste gjyqësore;
**6.** Inspektorët e ndërtimit të centralizohen përsëri me qëllim të kryerjes më efikase të punës së tyre, por edhe për shkak të zvogëlimit të rreziqeve nga kërcënimet, ofendimet, poshtërimet e çdoditshme, por edhe nga sulmet fizike me të cilat ballafaqohen ata në komunat e tyre;
**7.** Të stimulohet puna e inspektorëve dhe të caktohet se sa inspektorë nevojiten sipas numrit të banorëve të komunës, sepse tani numri i inspektorëve është ulur, ndërsa numri i lëndëve është rritur;
**8.** Të konstatohet deri ku është përgatitja e Rregullores për kompensim të rrezikut nga puna, të cilën është dashur ta përgatiste Këshilli i inspektorëve.



## ОПСЕЖНИ ДИСКУСИИ НА ЧЛЕНОВИТЕ НА УПРАВНИОТ ОДБОР НА ЗЕЛС ЗА АКТУЕЛНИТЕ ПРЕДИЗВИЦИ ВО ЛОКАЛНАТА ВЛАСТ

Управниот одбор на ЗЕЛС, на 15 ноември, 2018 година, во просториите на Заедницата, ја одржа седмата седница. Беа разгледани значајни прашања од актуелните состојби со кои се соочуваат локалните власти, а се говореше и за одредени активности на ЗЕЛС.

### Поддршка за формирањето на локални совети за справувањето со предизвиците со тероризмот, насилниот екстремизам и радикализацијата

Претставник од Национален комитет за спречување на насилен екстремизам и борба против тероризам, говореше пред членовите на УО на ЗЕЛС, за целите на ова тело и за неговото значење во справувањето со предизвиците со тероризмот, насилниот екстремизам и радикализацијата што се присутни на глобално, но и на регионално ниво. Во таа насока, беше посочено дека Националниот комитет во својата програма предвидува формирање на локални совети за превенција, во кои ќе учествуваат претставници и од локалната заедница. За формирањето на овие совети, како и за реализација на нивните активности, претставникот од Националниот комитет побара поддршка од локалната власт. Управниот одбор донесе заклучок ЗЕЛС да упати препорака до сите општини да обезбедат успешна, взаемна соработка со Националниот комитет во сите сегменти каде тоа општината може да го стори, а сè со цел навремено и адекватно справување со појавите на насилниот екстремизам и тероризам во нашата земја.

### Да не се отстапува од Правилникот за начинот и условите за овозможување на услугите кон општините

Присутните разгледаа и неколку дописи што локалните власти ги испратија до ЗЕЛС. Беше одбиено барањето на Општина Пласница да добие пристап до информацискиот систем за јавно наддавање при располагање со движни и недвижни ствари, што и беше одземен поради неисплатен долг кон ЗЕЛС, по основ на членарина. Всушност, ставот на Управниот одбор е да не се отстапува од Правилникот за начинот и условите за овозможување на услугите кон општините, што е донесен пред повеќе години, бидејќи тоа ќе предизвика неправичност во однос на општините кои редовно и навремено ја плаќаат членарината кон ЗЕЛС. Општините кои не можеле редовно да ја реализираат оваа обврска кон ЗЕЛС треба да го репрограмираат заостанатиот долг и да склучат нов договор со ЗЕЛС за негово отплаќање на повеќе рати. Членарината што ја плаќаат општините е главниот извор на финансирање на ЗЕЛС.

### ЗЕЛС се залага за продлабочување на децентрализацијата, а не за враќање назад, кон централизација

На седницата беше разгледан и дописот на Општина Гостивар за одземените надлежности во образованието, од страна на Министерот за образование и наука што се случи уште пред девет месеци. Управниот одбор заклучи да се упати допис до МОН да се вратат одземените надлежности на оваа општина, со цел таа да продолжи да ја спроведува и оваа децентрализирана

## DISKUTIME TË GJERA TË ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË BNJVL-së PËR SFIDAT AKTUALE NË PUSHTETIN LOKAL

Bordi Drejtues i BNJVL-së, më 15 nëntor 2018, në hapësirat e Asociacionit, mbajti seancën e tij të shtatë. U shqyrtuan çështje të rëndësishme për situatën aktuale me të cilën ballafaqohen pushtetet lokale, dhe u diskutua edhe për aktivitete të caktuara të BNJVL-së.

### Mbështetje për formimin e këshillave lokale për ballafaqim me sfidat e terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

Një përfaqësues nga Komiteti kombëtar për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, fliste para anëtarëve të Bordit drejtues të BNJVL-së për qëllimet e këtij organi dhe rëndësinë e tij në ballafaqimin me sfidat e terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që janë të pranishme në nivel global, por edhe në nivel rajonal. Në këtë drejtim, u theksua se Komiteti kombëtar në programin e tij parashikon formimin e këshillave lokale të parandalimit, në të cilat do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga bashkësia lokale. Për formimin e këtyre këshillave, si dhe për realizimin e aktiviteteve të tyre, përfaqësuesi i Komitetit kombëtar kërkoi mbështetje nga pushteti lokal. Bordi drejtues mori konkluzion që BNJVL-ja të dërgojë rekomandim në të gjitha komunat që të sigurojnë një bashkëpunim të suksesshëm dhe të ndërsjellë me Komitetin kombëtar në të gjitha segmentet, ku komuna mund të bëjë atë, dhe e gjithë kjo me qëllim të ballafaqimit me kohë dhe adekuat me dukuritë e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në vendin tonë.

### Të mos hiqet dorë nga Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e mundësimit të shërbimeve për komunat

Të pranishmit shqyrtuan edhe disa shkresa të cilat autoritetet lokale i dërguan në BNJVL. U refuzua kërkesa e komunës së Pllasnicës për të fituar qasje në sistemin e informacionit për ankand publik me prona të luajtshme dhe të paluajtshme që i posedon, qasje e cila iu mor për shkak të borxhit të papaguar ndaj BNJVL-së për anëtarësi. Në fakt, qëndrimi i Bordit drejtues është që të mos hiqet dorë nga Rregullorja për mënyrën dhe kushtet e mundësimit të shërbimeve për komunat, e cila ishte miratuar para disa vitesh, sepse kjo do të shkaktojë një pabarazi për komunat të cilat rregullisht dhe me kohë paguajnë tarifën e anëtarësisë ndaj BNJVL-së. Komunat të cilat nuk kanë pasur mundësi të realizojnë rregullisht këtë detyrim ndaj BNJVL-së duhet të riprogramojnë borxhin e mbetur dhe të lidhin një marrëveshje të re me BNJVL-në për shlyerjen e tij me më shumë këste. Tarifën e anëtarësisë që e paguajnë komunat është burimi kryesor i financimit të BNJVL-së.

### BNJVL-ja angazhohet për thellimin e decentralizimit, e jo për kthim prapa, drejt centralizimit

Në seancë u shqyrtua edhe shkresa e komunës e Gostivarit për kompetencat e marra në arsim, nga ana e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, që ndodhi nëntë muaj më parë. Bordi drejtues mori konkluzion që të dërgohet një shkresë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për t'i kthyer kompetencat e marra kësaj komune, me qëllim që të vazhdojë ajo me zbatimin e kësaj kompetence të decentralizuar. Bordi drejtues i BNJVL-së shprehu pakënaqësinë e tij lidhur me masën e këtillë drastike, të ndërmarrë nga MASH-i, sidomos që në periudhën e kaluar autoritetet lokale kishin shumë arsye objektive që të

надлежност. Управниот одбор на ЗЕЛС изрази незадоволство во однос на ваквата драстична мерка, презмена од МОН, особено, што во изминатиот период локалните власти имаа многубројни објективни причини да се откажат од истата и комплетно да ја предадат во надлежност на централната власт. Сепак, тоа не се случи во ниту еден момент, бидејќи единствена цел на локалните власти и на ЗЕЛС е развивање на децентрализацијата на власта, а не нејзино враќање назад, кон централизација.

### Изнесена иницијатива за враќање на статусот на месните заедници, како правни лица

Од страна на Општина Гостивар беше доставено и барање за покренување на иницијатива за враќање на статусот на месните заедници, како правни лица, што им беше одземен со Законот за локална самоуправа. Тоа ќе овозможи враќање на нивната функционалност, како и поголемо активирање на граѓаните во креирање на политиките и решавање на проблемите на локално ниво. Управниот одбор истакна дека на ова прашање треба да му се посвети посеопфатна и посериозна анализа. Исто така, беше посочено дека оваа иницијативата за измени на сегашниот статус на месните заедници треба да претставува дел од низа други клучни прашања од значење за сите единици на локалната самоуправа, што се дефинирани во Закон за локална самоуправа.

### Потреба од усогласување на разликите на цените утврдени во Уредбата за висината на цената на градежното земјиште...

Разгледана беше и иницијативата на Општина Кочани за измена на Уредбата за висината на цената на градежното земјиште, сопственост на РМ и висината на посебните трошоци за спроведување на постапките за отуѓување и давање под закуп, како и за засновање на право на стварна служебеност, што била доставена до општината, од страна на група на граѓани. Станува збор за утврдена цена за постапките при откуп на земјиштето по пат на непосредна спогодба, а најчест случај се постапките за стекнување со право за откуп на дворното место на градежната парцела врз основа на објект што добил правен статус. Во барањето е наведен пример дека согласно со Уредбата, за Општина Кочани за туристичката локација Пониква, на Осоговски Планини, висината на цената на градежното земјиште (дворно место за објекти А-4 времено домување) изнесува 900,00 денари/м2, додека за соседната општина, Пробиштип, исто така за Пониква, кое е на поатрактивна локација, утврдената цена е пониска и изнесува 500,00 денари/м2. Општината смета дека реакциите на граѓаните се основани. Управниот одбор на ЗЕЛС го разгледа барањето и ја задолжи стручната служба да се обрати до Владата на Република Македонија со барање да се усогласат разликите во цените утврдени во Уредбата, со цел да се стават во рамноправна положба општините, особено во граничните подрачја помеѓу две катастарски општини, а по претходна консултација со нив.

### Прифатен предлогот за иницирање на нов Закон за јавни патишта и повторно враќање на средствата од акцизата од деривати за нафта за општините

Сообраќајните инспектори и инспекторите за патен сообраќај од локалните власти се соочуваат со низа предизвици поврзани со спроведувањето на инспекциските постапки, односно

heqin dorë nga e njëjta dhe ta japin atë tërësisht në kompetencë të pushtetit qendror. Megjithatë, kjo nuk ndodhi në asnjë moment, sepse qëllimi i vetëm i autoriteteve lokale dhe i BNJVL-së është zhvillimi i decentralizimit të pushtetit, e jo kthimi i tij prapa, drejt centralizimit.

### Iniciohet iniciativa për kthimin e statusit të bashkësive lokale, si persona juridikë

Nga komuna e Gostivarit u dorëzua një kërkesë për ngritjen e një iniciative për kthimin e statusit të bashkësive lokale, si persona juridikë, që u morr me Ligjin për vetëqeverisje lokale. Kjo do të mundësojë kthimin e funksionalitetit të tyre, si dhe një aktivizim më të madh të qytetarëve në krijimin e politikave dhe zgjidhjen e problemeve në nivel lokal. Bordi drejtues theksoi se lidhur me këtë çështje duhet të bëhet një analizë më gjithëpërfshirëse dhe më serioze. U theksua gjithashtu se kjo iniciativë për të ndryshuar statusin aktual të bashkësive lokale duhet të jetë pjesë e një sërë çështjesh të tjera kyçe që janë të rëndësishme për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, që janë të përcaktuara në Ligjin për vetëqeverisje lokale.

### Nevojë për harmonizimin e dallimeve të çmimeve të përcaktuara në Rregulloren për shumën e çmimit të tokës ndërtimore...

U shqyrtua edhe iniciativa e komunës së Koçanit për ndryshimin e Rregullores për shumën e çmimit të tokës ndërtimore në pronësi të RM-së dhe shumën e shpenzimeve të veçanta për zbatimin e procedurave të tjetërsimit dhe dhënies me qira, si dhe për aplikimin e së drejtës për servitutin e sendeve, e cila është dërguar në komunë nga një grup qytetarësh. Bëhet fjalë për një çmim të përcaktuar për procedurat gjatë blerjes së tokës me anë të negociatave të drejtpërdrejta, ndërsa raste më të shpeshta janë procedurat për fitimin e së drejtës për blerjen e vendit të oborrit të parcelës ndërtimore në bazë të objektit që ka marrë status ligjor. Në kërkesën është përmendur një shembull se në bazë të Rregullores, për komunën e Koçanit, për vendin turistik Ponikvë, në malet e Osogovës, shuma e çmimit të tokës ndërtimore (vend oborri për objektet A4 strehim të përkohshëm) është 900,00 denarë/m2, ndërsa për komunën fqinje Probishtip, po ashtu për vendin Ponikvë, i cili është një lokacion më tërheqës, çmimi i përcaktuar është 500,00 denarë/m2. Komuna konsideron se reagimet e qytetarëve janë të bazuara. Këshilli drejtues i BNJVL-së shqyrtoi kërkesën dhe detyroi shërbimin profesional t'i drejtohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë me një kërkesë që të harmonizohen dallimet në çmimet e përcaktuara në Rregulloren, me qëllim që komunat të vihen në një pozitë të barabartë, sidomos në zonat kufitare midis dy komunave kadastrale, e pas një konsultimi paraprak me to.

### Pranohet propozimi për inicimin e një Ligji të ri për rrugët publike dhe kthimin e serishëm të mjeteve nga akciza e derivateve të naftës për komunat

Inspektorët e trafikut dhe inspektorët për trafikun rrugor nga autoritetet lokale përballen me një sërë sfidash që lidhen me zbatimin e procedurave të inspektimit, përkatësisht zbatimin e Ligjit për rrugët publike. Bëhet fjalë për procedurat që lidhen me automjetet e parkuara që pengojnë lëvizjen e pjesëmarrësve të tjerë në trafik, regjimin e transportit, ndërtimet dhe dëmtimin e rrugëve, mirëmbajtjen e instalimeve të instaluara në rrugët publike dhe të ngjashme, përkatësisht gjëra që kanë të bëjnë me rrugët publike, mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e tyre, e nuk janë të përfshira me dispozitat e ligjit në fuqi, ose të njëjtat nuk janë të plota. Me qëllim të sigurimit të zgjidhjeve adekuate ligjore, Rrjeti i inspektorëve të trafikut dhe inspektorëve të trafikut rrugor të

имплементирањето на Законот за јавни патишта. Станува збор за постапките поврзани со паркираните возила кои го попречуваат движењето на останатите учесници во сообраќајот, режимот на сообраќај, градби и оштетување на сообраќајниците, одржување на инсталации вградени во јавните патишта и слично, односно работи кои се поврзани со јавните патишта, нивната заштита и одржување, а не се опфатени со одредбите на законот кој е на сила, или истите се нецелосни. Со цел обезбедување на адекватни законски решенија, Мрежата на сообраќајни инспектори и инспектори за патен сообраќај при ЗЕЛС, подготви предлог-текст на нов Закон за јавните патишта и го достави на разгледување на Управниот одбор на ЗЕЛС. Предлогот беше во целост прифатен, но истовремено беше утврдено да се дополни со одредби кои се однесуваат на долгогодишното барање на ЗЕЛС за повторно враќање на средствата на локалните власти, од делот од акцизата од деривати за нафта, кои се користеа за изградба, реконструкција, рехабилитација, одржување и заштита на јавните патишта. Односно, да се утврди одредба со која, освен на сметка на Јавното претпријатие основано од Владата на Република Македонија, дел од средствата собрани од акциза од деривати од нафта, повторно да бидат приход на единиците на локалната самоуправа.

**Квалитетното спроведување на противпожарната заштита нарушено поради сериозни недостатоци на финансиските средства што ги добиваат општините за оваа намена**

ЗЕЛС подолг период посветуваат сериозно внимание на разрешувањето на предизвиците со кои се соочуваат локалните власти при спроведувањето на надлежностите поврзани

BNJVL-së, përgatiti projekt-tekstin e një Ligji të ri për rrugët publike dhe ia dërgoi për shqyrtim Bordit drejtues të BNJVL-së. Propozimi u pranua plotësisht, por njëkohësisht u theksua që teksti të plotësohet me dispozita që kanë të bëjnë me kërkesën e vjetër të BNJVL-së që t'u kthehen përsëri autoriteteve lokale mjetet nga pjesa e akcizës nga derivatet e naftës, të cilat janë përdorur për ndërtimin, rikonstruksionin, rehabilitimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike. Gjegjësisht, të përcaktohet një dispozitë me të cilën, përveç në llogarinë e Ndërmarrjes publike të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, një pjesë e mjeteve të mbledhura nga akciza e derivateve të naftës, të jenë përsëri të ardhura të njësive të vetëqeverisjes lokale.

**Zbatimi cilësor i mbrojtjes zjarrfikëse rrezikohet për shkak të mungesave serioze të mjeteve financiare që i marrin komunat për këtë qëllim**

BNJVL-ja një periudhë të gjatë kushton vëmendje serioze për zgjidhjen e sfidave me të cilat ballafaqohen autoritetet lokale gjatë zbatimit të kompetencave të lidhura me mbrojtjen zjarrfikëse të cilën e kryejnë njësitë territoriale të zjarrfikësve (NJTZ). Të pranishmit u informuan për mendimet e ndryshme të dërguara të komunave që janë përgjigjur në shkresën e BNJVL-së, në të cilën kërkohej të tregonin qëndrimin e tyre për një nga pesë qëndrimet e përcaktuara të propozuara rreth kompetencës së ardhme me NJTZ-të, të miratuara nga Grupi i formuar punues, i udhëhequr nga Ministria e Punëve të Brendshme, në të cilën kishte edhe një përfaqësues nga BNJVL-ja. Në propozimin e parë mbështetet qëndrimi: që sistemi i krizave të mbetet ashtu siç është, pa asnjë ndryshim. Qëndrimi i dytë është: Qendra e Menaxhimit të Krizave (QMK), Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shpëtimit (DMSH) dhe shërbimi i zjarrfikësve të jenë nën kompetencën e MPB-së, si një



со противпожарната заштита што ја вршат територијалните противпожарни единиците (ТППЕ). Присутните беа информирани за разноликоста на доставените мислења на општините кои одговорија на дописот на ЗЕЛС, во кој се бараше да го посочат својот став за еден од петте утврдени предлог - ставови околу идната надлежност со ТППЕ, донесени од страна на формираната работна група, раководена од Министерството за внатрешни работи, во која имаше и претставник од ЗЕЛС. Во првиот предлог се застапува ставот: системот за кризи да остане каков што е, без никакви измени. Вториот став е: Центарот за управување со кризи (ЦУК), Дирекцијата за заштита и спасување (ДЗС) и противпожарната служба да бидат под надлежност на МВР, како посебно биро. Третиот став е да се формира посебна агенција или дирекција, која ќе биде директно под ингеренции на Владата на РМ, каде би функционирале заедно ДЗС, ЦУК и ТППЕ. Четвртиот став е сите овие тела да бидат прифатени и да функционираат во склоп на Министерството за одбрана и последниот предлог –став е да се формира посебно Министерство за управување со кризи. Ова прашања предизвика сериозна дискусија меѓу присутните членови на Управниот одбор на ЗЕЛС. Дел од ставовите одеа во насока дека овие надлежностите треба да бидат вратени, со оглед на недоволните средства што општините ги добиваат од централната власт за нејзино спроведување, а дел го застапуваа ставот дека ЗЕЛС и локалните власти во континуитет се залагаат за развивање на децентрализацијата на власта и преземањето на нови надлежности, а не за нивно враќање. Беше посочено дека квалитетното спроведување на овие надлежности е доведено во прашање поради сериозните недостатоци на финансиски средства што ги префрла централната власт. Исто така има недостаток на вработени лица во ТППЕ, во однос на законски утврдените услови за нивна застапеност, според број на жители. Застарена е и материјално-техничката опременост со која располагаат ТППЕ, каде спаѓа самата опрема за пожарникарите, на возилата што тие ги користат, но застарени се и самите објекти каде се лоцирани. ТППЕ. Беше посочено дека недостасува и адекватна поддршка за континуирано јакнење на капацитетите на пожарникарите, односно за спроведување на соодветни обуки за нивна

Byro e veçantë. Qëndrimi i tretë është të formohet një Agjenci ose Drejtori të veçantë, e cila do të jetë nën kompetencat e drejtpërdrejta të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ku do të funksiononin së bashku me DMSH-në, QMK-në dhe NJTZ-të; Qëndrimi i katërt është që të gjitha këta trupa të pranohen dhe të funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe qëndrimi i fundit i propozuar është të formohet një ministri të veçantë për menaxhimin e krizave.

Kjo çështje shkaktoi një diskutim serioz midis anëtarëve të pranishëm të Bordit drejtues të BNJVL-së. Një pjesë e qëndrimeve shkonin në drejtimin që këto kompetenca duhet të kthehen, duke pasur parasysh mjetet e pamjaftueshme të cilat i marrin komunat nga pushteti qendror për zbatimin e saj, ndërsa pjesa tjetër përfaqësonin qëndrimin se BNJVL-ja dhe autoritetet lokale vazhdimisht angazhohen për zhvillimin e decentralizimit të pushtetit dhe marrjen e kompetencave të reja, e jo për kthimin e tyre. U theksua se zbatimi cilësor i këtyre kompetencave është vënë në pikëpyetje për shkak të mungesave serioze të mjeteve financiare që i transferon pushteti qendror. Po ashtu ka një mungesë të personave të punësuar në NJTZ-të, në lidhje me kushtet e përcaktuara ligjore për përfaqësimin e tyre, sipas numrit të banorëve. Janë vjetërsuar edhe pajisjet materiale dhe teknike që i kanë në dispozicion NJTZ-të, duke përfshirë pajisjet për zjarrfikësit, për automjetet që përdorin ata, por janë të vjetërsuara edhe vetë objektet, në të cilat janë të vendosur NJTZ-të. U theksua se mungon edhe mbështetja adekuate për përforcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të zjarrfikësve, gjegjësisht për zbatimin e trajnimeve përkatëse për avancimin e tyre profesional, sepse pamundësia që të pranohen kuadro të reja ka bërë që të rritet mosha e strukturës së zjarrfikësve në NJTZ-të. Bordi drejtues mori qëndrim se mbrojtja zjarrfikëse të cilën e kryejnë njësitë territoriale të zjarrfikësve duhet të mbetet në kuadër të pushtetit lokal, ndërsa të gjitha sfidat e kësaj fushe, kryesisht ato financiare, duhet të nxirren para Kuvendit të Përgjithshme të BNJVL-së, si dhe të zgjidhen me negociata të drejtpërdrejta me pushtetin qendror.

### Iniciativë për ndryshimin e Ligjit për veprimin me objektet e ndërtuara në mënyrë të paligjshme

Anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së shqyrtuan edhe iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimin me objektet e



професионална надградба, бидејќи неможноста да се примаат нови кадри, доведе до повисока старосната структура во ТППЕ. Управниот одбор утврди став дека противпожарната заштита што ја вршат територијалните противпожарни единици треба да остане во рамките на локалната власт, а сите предизвици од оваа област, пред сè финансиските, треба да бидат изнесени пред генералното собрание на ЗЕЛС, како и да се решаваат во директни преговори со централната власт.

## Иницијатива за измени во Законот за постапување со бесправно изградени објекти

Членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС ја разгледаа и иницијативата за изменување и дополнување на Законот за постапување со бесправно изградени објекти, што ја предложи градоначалникот на Општина Велес, Аце Коцевски. Станува збор за опфаќање на нова категорија објекти, кои се изградени по 3 март 2011 година, а кои не се пријавени, или за кои се бара да бидат легализирани, како да биле изградени пред 3 март 2011 година. Со иницијативата се предлагаше да се обезбеди период од една година, во кој сопствениците би ги пријавиле ваквите објекти, и истите би биле легализирани, а не срушени, доколку ги исполнуваат потребните услови за легализација и доколку би платиле двоен надомест од надоместокот утврден во постапката на издавање на одобрение за градење за соодветниот тип на градба. Исто така, се иницираше и измена со која изводот од сателитската снимка од теренот, направена пред 3 март 2011 година, да се смета како валиден доказен материјал во постапката за легализација. Така, на формираната комисијата, покрај обврската за увид и составување на записник за извршен увид на самото место со технички податоци и фотографии од истиот, се утврдува и обврската за обезбедување на дополнителен доказ – извадок од јавно достапна сателитска снимка на интернет, или други сателитски снимки да биде земен како доказен материјал. По оваа точка се поведе обемна дискусија во насока дека со секое продолжување на рокот за легализација на објектите досега, се правеа низа злоупотреби на терен, односно никнуваа нови нелегализирани објкети, за кои во меѓувреме се поднесуваа барања за нивна легализација. Беше посочено дека недостатокот на градежна инспекција е една од причините за понатамошното бесправно градење, како и состојбите со недоволно средства во буџетот на општината за рушење на ваквите нелегални објекти. Како причина за демотивација кај инспекторите, беше посочено и честото носење на одлуки од повисоките инстанци во жалбените постапки, во полза на граѓаните, бидејќи тешко се докажува дали објектот е изграден пред или по 3 март 2011 година. Во дискусијата присутните градоначалници ја посочија и потребата од сериозна примена на изрекување на кривична одговорност на граѓаните кои градат противзаконски, а има и такви кои градат дури и на државно земјиште, па предложија објектот што не добил правен статус на легален објект, да стане сопственост на општината. Така општините би имале свој имот, кој понатаму би имплицирал дополнителни приходи во буџетот на општината, или би се искористил при креирањето на социјалните или други политики на општината. Но, исто така, беше посочено, дека треба да се предвидат и поригорозни мерки за самите општини, доколку свесно не го почитуваат Законот, па дури и да им се одземат овие надлежности.

ndërtuara në mënyrë të paligjshme, të cilën e propozoi kryetari i komunës së Velesit, Ace Kocevski. Bëhet fjalë për përfshirjen e një kategorie të re të objekteve, që janë ndërtuar pas datës 3 mars 2011 dhe të cilat nuk janë raportuar ose për të cilat kërkohet të legalizohen, sikur të ishin ndërtuar para datës 3 mars 2011. Me iniciativën propozohej të sigurohej një periudhë prej një viti, në të cilën pronarët do t'i raportonin objektet e këtilla, dhe ato do të legalizoheshin, e jo të rrënoheshin, nëse i plotësojnë kushtet e nevojshme për legalizim dhe nëse paguajnë kompensimin e dyfishtë të kompensimit të përcaktuar në procedurën e lëshimit të vendimit të ndërtimit për llojin përkatës të objektit. Po ashtu u iniciua edhe një ndryshim, me të cilin ekstrakti i incizimit satelitor nga terreni, i bërë para datës 3 mars 2011, të konsiderohet si material i vlefshëm provues në procedurën e legalizimit. Kështu, komisionit të formuar, përveç obligimit për inspektim dhe përpilim të një procesverbali për një inspektim të kryer në vendin e ndërtimit me të dhëna teknike dhe fotografi nga i njëjti objekt, i përcaktohet edhe obligimi për sigurimin e një prove shtesë - ekstrakt nga një incizimi publik satelitor ose incizime të tjera satelitore që janë në dispozicion në internet, të merret si material provues.

Pas kësaj pike u zhvillua një diskutim të gjerë në drejtim se me çdo vazhdim të afatit për legalizimin e objekteve deri më tani, janë bërë një seri keqpërdorimesh në terren, gjegjësisht paraqiteshin objekte të reja të palegalizuara, për të cilat në ndërkohë parashtroheshin kërkesa për legalizimin e tyre. U theksua se mungesa e inspektimit të ndërtimit është një nga arsyet për ndërtimin e mëtejshëm të paligjshme, si dhe gjendjet me mjete të pamjaftueshme në buxhetin e komunës për rrënimin e objekteve të këtilla të paligjshme. Si një arsye për demotivimin e inspektorëve u theksua edhe miratimi i shpeshtë i vendimeve nga instancat më të larta në procedurat ankimore, në favor të qytetarëve, për shkak se është e vështirë të dëshmohet nëse objekti është ndërtuar para apo pas datës 3 mars 2011. Në diskutim, kryetarët e pranishëm të komunave theksuan edhe nevojën për zbatimin serioz të shqiptimit të përgjegjësisë penale të qytetarëve, të cilët ndërtojnë në mënyrë të paligjshme, dhe ka nga ata që ndërtojnë edhe në tokë shtetërore, kështu që propozuan objekti i cili nuk ka marrë statusin ligjor të një objekti ligjor, të bëhet pronë e komunës. Kështu, komunat do të kishin pronën e tyre, e cila më tej do të implikonte të ardhura shtesë në buxhetin e komunës, ose ato do të mund të përdoreshin për krijimin e politikave sociale ose politikave të tjera të komunës. Por, u theksua gjithashtu se duhet të parashihen masa më të rrepta për vetë komunat, nëse ato me vetëdije nuk e respektojnë Ligjin dhe madje t'u merren këto kompetenca.

Në fund të diskutimit, Bordi drejtues i BNJVL-së miratoi përmbajtjen e iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veprimin me objektet e ndërtuara në mënyrë të paligjshme, të parashtruar nga komuna e Velesit, ku u përcaktua që afati i fundit për parashtrimin e kërkesës për përcaktimin e statusit të objekteve të paligjshme të vazhdohet për 6 muaj, edhe atë për objektet që janë ndërtuar pas datës 3 mars 2011, përfundimisht me ditën e hyrjes së këtij ndryshimi të Ligjit në fuqi. Po ashtu, u theksua që komuna të ketë të drejtë që në mënyrë të pavarur të iniciojë procedurë sipas detyrës zyrtare për objektet për të cilat nuk do të parashtrohet kërkesë për përcaktimin e statusit juridik, me atë që objekti statusi i të cilit juridik do të përcaktohet në kuadër të kësaj procedure do të regjistrohet në pronësi të komunës. Dhe lidhur me kompensimin për përcaktimin e statusit juridik për objektet për të cilat do të parashtrohet kërkesë për përcaktimin e statusit juridik, e janë ndërtuar pas datës 3 mars 2011, përfundimisht me ditën e hyrjes së këtij ndryshimi të Ligjit në fuqi, ai të jetë i barabartë me shumën e kompensimit të paraparë për përcaktimin e tokës ndërtimore.

На крајот од дискусијата Управниот одбор на ЗЕЛС ја усвои содржината на иницијативата за изменување и дополнување на Законот за постапување со бесправно изградени објекти, поднесена од Општина Велес, при што беше утврдено крајниот рок за поднесување на барање на утврдување на статус на бесправни објекти да се продолжи за 6 месеци, и тоа за објектите кои се изградени по 3 март 2011 година, заклучно со денот на стапување на сила на измената на Законот. Исто така, беше утврдено општината самостојно да има право да поведе постапка по службена должност за објектите за кои нема да се поднесе барање за утврдување на правен статус, со тоа што објектот чиј што правен статус ќе биде утврден во рамките на оваа постапка, ќе биде запишан во сопственост на општината. И во однос на надоместокот за утврдување на правен статус за објектите, за кои ќе биде поднесено барање за утврдување на правен статус, а биле изградени по 3 март 2011 година, заклучно со денот на стапување на сила на оваа измена на Законот, тој да биде еднаков на висината на предвидениот надоместок за уредување на градежно земјиште.

## Трета седница на Генералното собрание на ЗЕЛС закажана за 14 декември 2018 година, во Скопје

Како осма точка од дневниот ред на седницата на Управниот одбор на ЗЕЛС беше усвојувањето на одлуката за одржување на третата седница на Генералното собрание на ЗЕЛС, при што беа разгледани и усвоени: Предлог -акцискиот план на ЗЕЛС за 2019 година, Предлог-буџетот на ЗЕЛС за 2019 година и Предлог –планот за јавни набавки на ЗЕЛС, за следната година. Беше договорено седницата да се одржи на 14 декември 2018 година во Скопје, а на истиот ден да се организира конференција на која ќе присуствуваат претставници од Владата на Република Македонија и сите делегати на Генералното собрание на ЗЕЛС. На оваа конференција ќе бидат изнесени предизвиците на локалните власти, особено оние во делот на обезбедувањето на поголема финансиска стабилност на општините.

## Изнесен прегледот на состојбите на долговите на јавните претпријатија, основани од општините

На иницијатива на градоначалникот на Општина Куманово, Максим Димитриевски, ЗЕЛС изготви преглед на состојбите на долговите на јавните претпријатија, основани од општините, кои се однесуваат на неплатени долгови кон УЈП, МФ и други државни институции, како и други обврски кон јавни установи, организации и фондови основани од државата. Овој долг изнесува приближно околу три милиони денари. Присутните беа информирани за овој преглед, при што беше посочено дека една од главните причини за настанување на овие долгови е обврската за плаќање на ДДВ и каматите произлезени по овој основ. Управниот одбор донесе заклучок да се бара надлежниот орган да изврши отпис на каматите, а плаќањето на настанатиот долг да биде регулирано преку спогодби за плаќање на рати, сразмерно на можностите.

## Упатено барање до МОН за изнаоѓање на решение за превозот на вработените во образованието, во руралните средини

Самостојниот синдикат за образование, наука и култура на Република Македонија – СОНК, се обрати до ЗЕЛС со барање

## Seanca e tretë e Kuvendit të Përgjithshëm të BNJVL-së është caktuar për 14 dhjetor 2018, në Shkup

Si pikë e tetë e rendit të ditës në seancën e Bordit drejtues të BNJVL-së ishte miratimi i vendimit për mbajtjen e seancës së tretë të Kuvendit të Përgjithshëm të BNJVL-së, kështu që u shqyrtuan dhe u miratuan: Projekt-plani aksional i BNJVL-së për vitin 2019, Projekt-buxheti i BNJVL-së për vitin 2019 dhe Projekt-plani i furnizimeve publike të BNJVL-së për vitin e ardhshëm. U ra dakord që seanca të mbahet më 14 dhjetor 2018 në Shkup, ndërsa në të njëjtën ditë të organizohet një konferencë në të cilën do të marrin pjesë përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe të gjithë delegatët e Kuvendit të Përgjithshme të BNJVL-së. Në këtë konferencë do të nxirren sfidat e autoriteteve lokale, veçanërisht ato në pjesën e sigurimit të stabilitetit më të madh financiar të komunave.

## Është iniciuar pasqyra e gjendjeve të borxheve të ndërmarrjeve publike, të themeluara nga komunat

Me iniciativën e kryetarit të komunës së Kumanovës, Maksim Dimitrievski, BNJVL-ja përgatiti një pasqyrë të gjendjeve të borxheve të ndërmarrjeve publike, të themeluara nga komunat, që kanë të bëjnë me borxhet e papaguara ndaj Drejtorisë së të Hyrave Publike (DHP), Ministrisë së Financave (MF) dhe institucioneve të tjera shtetërore, si dhe detyrime të tjera ndaj institucioneve, organizatave dhe fondeve publike, të themeluara nga shteti. Ky borxh është rreth tre milionë denarësh. Të pranishmit u informuan për këtë pasqyrë, me ç'rast u theksua se një nga shkaqet kryesore për krijimin e këtyre borxheve është detyrimi për pagesën e TVSH-së dhe kamatat që dalin mbi këtë bazë. Bordi drejtues mori një konkluzion që të kërkohet nga organi kompetent për të kryer një fshirje të kamatave, ndërsa pagesa e borxhit të krijuar të rregullohet përmes marrëveshjeve për të paguar me këste, sipas mundësive të komunave.

## Është dërguar kërkesë në MASH për gjetjen e një zgjidhjeje për transportin e të punësuarve në arsim në zonat rurale

Sindikata e Pavarur e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Maqedonisë - SASHK, iu drejtua BNJVL-së me një kërkesë për zgjidhjen e problemit lidhur me shpenzimet e udhëtimit të të punësuarve në arsim. Me kalkulimin e këtyre shpenzimeve në pagën bruto, u paraqit një problem sidomos për ata punonjës të cilët udhëtojnë më shumë kilometra deri në vendin e punës në zonat rurale dhe për këtë gjë ndahen mjete shtesë nga të ardhurat e tyre. Bordi drejtues konstatoi se, duke marrë parasysh mungesën e madhe të mjeteve financiare të cilat i marrin autoritetet lokale nga pushteti qendror për zbatimin e kompetencave në arsim, të dërgohet një kërkesë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për gjetjen e një zgjidhjeje adekuate për sigurimin e mjeteve të nevojshme për zgjidhjen e këtij problemi serioz për një pjesë të punonjësve në arsim.

## Rekomandimi për kryetarët e komunave për të emëruar persona nga administrata komunale për ndihmën dhe përkrahjen e Këshillit të komunës

Në seancë u nxor edhe propozimi që doli nga seanca e fundit e Komitetit të këshillave të BNJVL-së për nevojën për krijimin e një departamenti ose një sektori të veçantë për ndihmën dhe përkrahjen e këshillave të

за решавање на проблем во врска со патните трошоци на вработените во образованието. Со калкулирањето на овие трошоци во бруто платата, се јави проблем особено за оние вработени кои патуваат повеќе километри до работното место, во руралните средини и за тоа одвојуваат дополнителни средства од своите приходи. Управниот одбор констатира дека и со оглед на и онака големиот недостаток на финансиски средства што локалните власти ги добиваат од централната власт за спроведување на надлежностите во образованието да се упати барање до Министерството за образование и наука за изнаоѓање на соодветно решение за обезбедување на потребните средства за решавање на овој сериозен проблем за дел од вработените во образованието.

## Препорака до градоначалниците да назначат лица од општинската администрација за помош и поддршка на Советот на општината

На седницата беше изнесен и предлогот што произлезе од последната седница на Комитетот на советите при ЗЕЛС за потребата од формирање на посебно одделение или сектор за помош и поддршка на советите на општината, во зависност од големината на општината, што ќе биде одговорно единствено пред Советот на општината. Од страна на УО на ЗЕЛС беше посочено дека сите вработени од општинската администрација имаат обврски како пред градоначалникот на општината, така и пред Советот на општината, така што секој службеник треба да биде на располагање на Советот на општината, во зависност од областа во која се бара помош и да ја врши својата работа според описот и пописот на работното место, а во согласност со законските одредби. Во таа насока УО на ЗЕЛС упати препорака до сите општини да предвидат во систематизацијата соодветни работни места за државни службеници чии работни задачи ќе соодветствуваат со потребите на Советот на општината и да изнајдат соодветни услови за работа на советниците.

## Неприфатлив предлогот за измена на составот на Комисијата за спроведување на постапката за давање на земјоделското земјиште во државна сопственост под закуп

Предмет на дискусија на седницата беше и измената што се предвидува со Предлог – законот за дополнување и изменување на Законот за земјоделско земјиште, со која се предвидува во работата на Комисијата за спроведување на постапката за давање на земјоделското земјиште во државна сопственост под закуп, да учествува само еден член на ЗЕЛС, односно се предвидува иземање на членовите на ЗЕЛС, назначени во Комисијата од страна на единиците на локалната самоуправа на чија територија се издава земјиштето предмет на закуп. Беше утврден негативен став по однос на оваа измена, од причини што решението е непромислено и неприфатливо и би довело до попречување на увидот на локалната самоуправа за активностите што се извршуваат на нејзината територија од страна на централната власт.

komunës, varësisht nga madhësia e komunës, i cili do të ketë përgjegjësi vetëm para Këshillit të komunës Nga ana e Bordit drejtues të BNJVL-së u theksua se të gjithë të punësuarit e administratës komunale kanë detyra si para kryetarit të komunës, ashtu edhe para këshillit të komunës, kështu që çdo nëpunës duhet të jetë në dispozicion të këshillit të komunës, varësisht nga sfera në të cilën kërkohet ndihma dhe të kryejë punën e tij sipas përshkrimit dhe regjistrimit të vendit të punës, e në përputhje me dispozitat ligjore. Në këtë drejtim, Bordi drejtues i BNJVL-së dërgoi një rekomandim në të gjitha komunat që të parashikojnë në sistematizimin vende përkatëse të punës për nëpunësit shtetërorë, detyrat e punës të të cilëve do të korrespondojnë me nevojat e Këshillit të komunës dhe të gjejnë kushte përkatëse për punën e këshilltarëve.

## Propozimi për ndryshimin e përbërjes së Komisionit për zbatimin e procedurës për dhënien e tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira është i papranueshëm

Objekt i diskutimit në seancë ishte edhe ndryshimi që parashihet me Projekt-ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tokën bujqësore, me të cilin parashihet që në punën e Komisionit për zbatimin e procedurës për dhënien e tokës bujqësore në pronësi të shtetit me qira, të marrë pjesë vetëm një anëtar i BNJVL-së, përkatësisht parashihet përjashtimi i anëtarëve të BNJVL-së, të emëruar në Komision nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale në territorin e së cilës jepet toka që është objekt i dhënies me qira. U konstatua një qëndrim negativ lidhur me këtë ndryshim, për arsye se zgjidhja është e palogjikshme dhe e papranueshme dhe do të shkaktonte një pengim të inspektimit të vetëqeverisjes lokale për aktivitetet që kryhen në territorin e saj nga ana e pushtetit qendror.

## Miratimi i vendimeve ligjore pa një konsultim paraprak dhe një mendim të nxjerrë nga pushteti lokal është i papranueshëm

Anëtarët e pranishëm të Bordit drejtues të BNJVL-së shprehën pakënaqësi të madhe për mënyrën e propozimit dhe miratimit të dy ligjeve të rëndësishme, pa asnjë konsultim të njësive të vetëqeverisjes lokale, edhe pse bëhet fjalë për ligje shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjëra thelbësore nga sfera e punës financiare të komunave. Me ndryshimin e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale, të ardhurat vetanake të buxhetit bazë të komunës (të ardhurat tatimore, të ardhurat jo-tatimore, të ardhurat kapitale dhe transferet pa dotacion nga Tatimi i Vlerës së Shtuar) mund të planifikohen me një rritje prej më së shumti 10% nga të ardhurat e realizuara mesatare në tri vitet e fundit, sipas të dhënave nga evidenca e trezorit. Ndryshimi i këtillë paraqet një lloj kufizimi të buxheteve komunale, e me atë bëhet edhe kufizim i kryerjes së punës dhe kompetencave të njësive të vetëqeverisjes lokale, pamundësi për një krijim të politikave të zhvillimit, si dhe mundësi për një paqëndrueshmëri të tyre eventuale financiare.

Ligji për mbështetjen financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të përdoruesve individualë, të themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, për financimin e detyrimeve të ardhura, por të papaguara, ka të bëjë me mbulimin e 51% të shumës së raportuar totale të detyrimeve të ardhura, por të papaguara të komunave dhe përdoruesve individualë, përfundimisht me muajin shtator të vitit 2018. Shuma e mjeteve të cilën do ta marrë çdo njësi e vetëqeverisjes lokale është përcaktuar në vetë tekstin e ligjit. U theksua se shpërndarja e bërë në këtë mënyrë pa një plan dhe analizë përkatëse dhe pa konsultim me vetëqeverisjen lokale, e cila

## Неприфатливо носење на законски решенија без претходна консултација и изнесено мислење од локалната власт

Присутните членови на Управниот одбор на ЗЕЛС изразија огромно незадоволство од начинот на предлагање и носење на двата важни закони, без никаква консултација на единиците на локалната власт, иако станува збор за исклучително важни закони кои се однесуваат на суштински работи од областа на финансиското работење на општините. Со измената во Законот за финансирање на единиците на локалната самоуправа, сопствените приходи на основниот буџет на општината (даночни приходи, неданочни приходи, капитални приходи и трансфери без дотација од данокот од додадена вредност) може да се планираат со пораст од најмногу 10% од просечно остварените приходи во последните три години, според податоците од трезорската евиденција. Ваквата измена претставува своевидно ограничување на општинските буџети, а со тоа и ограничување на вршењето на работата и надлежностите на единиците на локалната самоуправа, неможност за креирање на политики за развој, како и можност за нивна евентуална финансиска нестабилност.

Законот за финансиска поддршка на единиците на локалната самоуправа и единки-корисници, основани од единиците на локалната самоуправа, за финансирање на доспеани а неплатени обврски, се однесува на покривање на 51% од вкупниот пријавен износ на доспеани а неплатени обврски, на општините и единките-корисници, заклучно со месец септември 2018 година. Износот на средства кој ќе го добие секоја единица на локалната самоуправа е утврден во самиот текст на законот.

Беше посочено дека вака направената распределба без соодветен план и анализа и без консултација со локалната самоуправа, која се темели само на електронската евиденција за пријавување на доспеани обврски е неправедна и дека дел од општините на овој начин ќе бидат незаслужно наградени. Посочи и дека ваквиот потег на Владата на Република Македонија е за поздравување, но дека е сосема спротивно од она што претходно е ветено, односно овозможување на кредити со ниски каматни стапки и отплата на долгот на подолг временски период. Присутните членови посочија дека е потребна итна средба со претседателот на Владата на Република Македонија и со министерот за финансии на која ќе се дискутира оваа состојба, а би се отвориле и прашањата околу обезбедување на стабилни извори на финансирање на единиците на локалната самоуправа. На седницата беа избрани и градоначалниците кои ќе учествуваат на оваа средбата, односно претседателот на ЗЕЛС, заедно со потпретседателите и градоначалниците на општините: Велес, Штип, Битола, Карпош и Куманово.

## Утврдени членовите на осумте комисии при ЗЕЛС

На оваа седница Управниот одбор ги усвои и Предлогот за формирање на осумте комисии во ЗЕЛС, како и нивниот состав. Комисиите, како и мрежите при ЗЕЛС, претставуваат многу важна алатка при разработувањето на ставовите на локалните власти за прашања поврзани со надлежностите на единиците на локалната власт. Комисиите се составени исклучиво од градоначалници, а при утврдувањето во која комисија да членуваат, беше земено предвид нивното занимања, како и обезбедувањето на континуитет на членството во работењето на комисиите.

bazohet vetëm në evidencën elektronike për raportimin e detyrimeve të ardhura, është bërë dhe se një pjesë e komunave në këtë mënyrë do të shpërblehen pa meritë. U theksua se ky veprim i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë është për t'u përshëndetur, por se është tërësisht në kundërshtim me atë që është premtuar paraprakisht, gjegjësisht është një mundësim i kredive me norma të ulëta të kamatës dhe një shlyerje e borxhit për një periudhë më të gjatë kohore. Anëtarët e pranishëm theksuan se nevojitet një takim urgjent me Kryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Ministrin e Financave, në të cilin do të diskutohet kjo gjendje, dhe do të hapeshin edhe çështjet lidhur me sigurimin e burimeve të qëndrueshme të financimit të njësive të vetëqeverisjes lokale. Në seancë u zgjodhën edhe kryetarët e komunave të cilët do të marrin pjesë në këtë takim, përkatësisht Kryetari i BNJVL-së, së bashku me nënkryetarët dhe kryetarët e komunave: Velesi, Shtipi, Manastiri, Karposhi dhe Kumanova.

## Janë përcaktuar anëtarët e tetë komisioneve të BNJVL-së

Në këtë seancë Bordi drejtues miratoi edhe Propozimin për formimin e tetë komisioneve të BNJVL-së, si dhe përbërjen e tyre. Komisionet, si dhe Rrjetet e BNJVL-së janë një vegël shumë e rëndësishme për përpunimin e qëndrimeve të autoriteteve lokale për çështje të lidhura me kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale. Komisionet përbëhen vetëm nga kryetarë komunash, ndërsa gjatë përcaktimit se në cilin komision të marrin pjesë u morr në konsideratë profesioni i tyre, si dhe sigurimi i vazhdimësisë së anëtarësisë në punën e komisioneve.






## ПРЕТСТАВНИЦИ ОД ЗЕЛС СЕ СРЕТНАА СО ПРЕМИЕРОТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА И МИНИСТЕРОТ ЗА ФИНАНСИИ

Претседателот на ЗЕЛС, Петре Шилегов, потпретседателот Висар Ганиу, градоначалниците: Аце Коцевски, Благој Бочварски, Саша Богдановиќ и Стефан Богоев , како и извршната директорка на ЗЕЛС, Душица Перишиќ, на 19 ноември 2018 година имаа средба со претседателот на Владата на Република Македонија, Зоран Заев и министерот за финансии, Драган Тевдовски. Средбата беше одржана на барање на Управниот одбор на ЗЕЛС, кога на седмата седница што се одржа на 15 ноември 2018 година беше донесен заклучок да се формира работна група која ќе ги изнесе предизвиците со кои се соочуваат локалните власти при имплементирањето на измените на Законот за дополнување на Законот за финансирање на единиците на локалната самоуправа и на Законот за финансиска поддршка на единиците на локална самоуправа и единки корисници, основани од единиците на локална самоуправа за финансирање на доспеани, а неплатени обврски.

На почетокот на средбата присутните членови на Управниот одбор на ЗЕЛС го поздравија потегот на Владата на Република Македонија, за обезбедување на финансиските средства во висина од 50 милиони евра, за покривање на дел од долговите на локалните власти, но беше истакнато дека овој потег е направен сосема спротивно од претходните ветувања на Владата за обезбедување на поволен кредит, со ниски каматни стапки и отплата на долгот на поголем временски период. Градоначалниците изразија незадоволство и од начинот на предлагање и на носење на двата важни закони, што беше сторено без претходна консултација на единиците на локалната власт, особено што станува збор за исклучително важни закони кои се однесуваат на суштински работи од областа на финансиското работење на општините. На средбата беа прецизно образложени сите забелешки што беа изнесени на Управниот одбор на ЗЕЛС, поединечно за секој од овие два закона. Претседателот на Владата на Република Македонија, Зоран Заев, на оваа средба рече дека педесетте милиони евра се

## PËRFAQËSUESIT E BNJVL-së U TAKUAN ME KRYEMINISTRIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË DHE MINISTRIN E FINANCAVE

Kryetari i BNJVL-së, Petre Shilegov, nënkryetari Visar Ganiu, kryetarët e komunave: Ace Kocevski, Bllagoj Boçvarski, Sasha Bogdanoviq dhe Stefan Bogoev, si dhe drejtoresha ekzekutive e BNJVL-së, Dushica Perishiq, më 19 nëntor 2018 patën takim me kryetarin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev dhe Ministrin e Financave, Dragan Tevdovski. Takimi u mbajt me kërkesë të Bordit drejtues të BNJVL-së, kur në seancën e shtatë që u mbajt më 15 nëntor 2018 u mor një konkluzion që të formohet një grup punues që do të prezantojë sfidat me të cilat ballafaqohen autoritetet lokale gjatë implementimit të ndryshimeve të Ligjit për plotësimin e Ligjit për financimin e njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të Ligjit për mbështetjen financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe individëve-përdorues, të themeluar nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për financimin e detyrimeve të arritura, por të papaguara.

Në fillim të takimit, anëtarët e pranishëm të Bordit drejtues të BNJVL-së përshëndetën veprimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për sigurimin e mjeteve financiare në vlerë prej 50 milionë eurosh për të mbuluar një pjesë të borxheve të autoriteteve lokale, por u theksua se ky veprim është bërë tërësisht në kundërshtim me premtimet e mëparshme të Qeverisë për sigurimin e një kredie të volitshme, me norma të ulëta të interesit dhe shlyerjen e borxhit për një periudhë më të gjatë kohore. Kryetarët e komunave shprehën pakënaqësi edhe për mënyrën e propozimit dhe miratimit të dy ligjeve të rëndësishme, gjë që është bërë pa konsultim paraprak të njësive të pushtetit lokal, veçanërisht se bëhet fjalë për ligje jashtëzakonisht të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjërat thelbësore të sferës së punës financiare të komunave. Në takim u shpjeguan saktësisht të gjitha vërejtjet që u nxorën në Bordin drejtues të BNJVL-së, individualisht për secilën nga këto dy ligje.

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev në këtë takim tha se pesëdhjetë milionë eurot janë ndarë si një mbështetje për komunat në formën e ndihmës së njëhershme fi-



одвоени како поддршка на општините во форма на еднократна финансиска инјекција, за да можат градоначалниците да ги стабилизираат развојните капацитети на своите општини. Тој додаде дека Владата има заложба да ја помогне работата на општините, со цел проектирање и реализација на повеќе развојни и капитални проекти, со што граѓаните ќе добиваат подобри услуги за даноците кои ги плаќаат и ќе бидат комплетно информирани за трошењето на тие средства. Премиерот истакна дека сите предлози кои доѓаат од ЗЕЛС се добродојдени и се во духот на конструктивноста во пристапот на решавањето на актуелните проблеми со задолженоста на локалните самоуправи во Македонија, како и за финансиско стабилизирање на општините. Министерот за финансии, Тевдовски, пак, појасни дека со законските измени, планирањето на буџетите на општините ќе се базира на реална основа. Според Тевдовски, станува збор за мерка која претставува гаранција дека проблемот со задолжувањето на општините нема да се повтори, ќе се спречат таложењата на неплатени обврски и ќе се подобри финансиското работење на општините.

nanciare, që të mund kryetarët e komunave t'i stabilizojnë kapacitetet zhvillimore të komuniteteve të tyre. Ai shtoi se Qeveria është e angazhuar për të ndihmuar punën e komunave, me qëllim të projektimit dhe realizimit të më shumë projekteve zhvillimore dhe kapitale, me çka qytetarët do të marrin shërbime më të mira për tatimet që i paguajnë dhe do të informohen plotësisht për shpenzimin e këtyre mjeteve. Kryeministri theksoi se të gjitha propozimet që vijnë nga BNJVL-ja janë të mirëpritura dhe janë në frymën e qasjes konstruktive në zgjidhjen e problemeve aktuale me borxhet e vetëqeverisjeve lokale në Maqedoni, si dhe për stabilizimin financiar të komunave.

Ministri i Financave, Tevdovski, shpjegoi se me ndryshimet ligjore, planifikimi i buxheteve të komunave do të bazohet në një bazë reale. Sipas Tevdovskit, bëhet fjalë për një masë që është një garanci se problemi me borxhet e komunave nuk do të përsëritet, do të parandalohet grumbullimi i detyrimeve të papaguara dhe do të përmirësohet puna financiare e komunave.

## ИНИЦИЈАТИВА ЗА ЗАДОЛЖИТЕЛНО УТВРДУВАЊЕ НА РАБОТНО МЕСТО ВО ОПШТИНАТА: КООРДИНАТОР ЗА ЕДНАКВИ МОЖНОСТИ

ЗЕЛС организираше заедничка средба на претседателите на комисиите за еднакви можности при општините, на координаторите на овие комисии и нивните заменици, а беше поканет и претставник од Секторот за еднакви можности при Министерството за труд и социјална политика (МТСП). Средбата се одржа во ЗЕЛС тренинг центарот, на 28 ноември 2018 година. Присутните дискутираа за активности кои произлегуваат од Оперативниот план на ЗЕЛС за родова еднаквост за 2018 година, но говореа и за имплементацијата на обврските од Истанбулската конвенција за 2019 година, препорачани и за општините од страна на Владата на Република Македонија. Претставничката од МТСП изнесе повеќе практични насоки за поефикасно планирање на програмите за родова еднаквост во општините и одговараше на прашања од присутните за предизвиците со кои тие се соочуваат при имплементацијата на Законот за еднакви можности. По опсежна дискусија и изнесувањето на низа предизвици со кои се соочуваат локалните власти за реализација на активности од областа на родовата еднаквост беа донесени повеќе заеднички заклучоци:

## INICIATIVA PËR PËRCAKTIMIN E DETYRUESHËM TË VENDIT TË PUNËS NË KOMUNË: KOORDINATOR PËR MUNDËSI TË BARABARTA

BNJLV-ja organizoi një takim të përbashkët të kryetarëve të komisioneve për mundësi të barabarta në komuna, koordinatorëve të këtyre komiteteve dhe zëvendësve të tyre, ndërsa u ftua edhe një përfaqësues nga Sektori për mundësi të Barabarta në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Takimi u mbajt në Qendrën e Trajnimeve të BNJVL-së më 28 nëntor 2018. Të pranishmit diskutuan për aktivitetet që dalin nga Plani operativ i BNJVL-së për barazi gjinore për vitin 2018, por folën edhe për implementimin e detyrimeve të Konventës së Stambollit për vitin 2019, të rekomanduara edhe për komunat nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë. Përfaqësuesja e MPPS-së nxori më shumë udhëzime më praktike për një planifikim më efikas të programeve për barazi gjinore në komuna dhe u përgjigjej pyetjeve të të pranishmëve lidhur me sfidat me të cilat ballafaqohen gjatë implementimit të Ligjit për mundësi të barabarta. Pas diskutimit të gjerë dhe prezantimit të një sërë sfidash me të cilat ballafaqohen autoritetet lokale për realizimin e aktiviteteve të sferës së barazisë gjinore, u miratuan disa konkluzione të përbashkëta:



**1.** Пред МТСП, МИОА, Агенцијата за администрација, меѓуресорската советодавна група за еднакви можности, да се иницира задолжително утврдување на работно место координатор за еднакви можности во општината, што ќе се стави во систематизацијата на работни места. Целта е поефикасно и поквалитетно да се спроведуваат обемните активности од оваа област во локалната власт.
**2.** Советниците и вработените во општините кои работат на полето на родова еднаквост и родово одговорно буџетирање да имаат континуирани и квалитетни обуки. Притоа, ЗЕЛС во соработка со МТСП и други релевантни институции да имаат активна улога.
**3.** Да се организираат почести регионални обуки и работилници, како и да се искористат можностите за меѓуопштинската соработка и во областа на родовата еднаквост.
**4.** Во рамките на општината да се иницира формирање на меѓуресорска работна група, со цел поголема родова сензибилизација.
**5.** Зајакнување на соработката со граѓанските организации за спроведување на одредени активности на општината во рамките на Програмата за еднакви можности (креирање на дијалог и насочување на граѓанските организации кон развивање на проекти од интерес на општината).
**6.** Со цел обезбедување на континуитет во работата на Комисијата за еднакви можности, 20% од советниците во оваа Комисијата да се од претходниот состав.

**1.** Para MPPS-së, MSHIA-së, Agjencisë së administratës, grupit ndërresor këshillëdhënës për mundësi të barabarta, të iniciohet përcaktimi i detyrueshëm i vendit të punës "koordinator për mundësi të barabarta në komunë", që do të vihet në sistematizimin e vendeve të punës. Qëllimi është që të zbatohen në mënyrë më efikase dhe më cilësore aktivitetet voluminoze të kësaj sfere në pushtetin lokal.
**2.** Këshilltarët dhe të punësuarit në komunë që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe buxhetimit përgjegjës për barazi gjinore të kenë trajnime të vazhdueshme dhe cilësore. Njëkohësisht, BNJVL-ja në bashkëpunim me MPPS-në dhe institucione të tjera relevante të kenë një rol aktiv.
**3.** Të organizohen trajnime dhe punëtori më të shpeshta rajonale, si dhe të shfrytëzohen mundësitë për një bashkëpunim ndërkomunal edhe në sferën e barazisë gjinore.
**4.** Në kuadër të komunës të iniciohet formimi i një grupi ndërresor punues me qëllim të sensibilizimit më të madh për barazinë gjinore.
**5.** Përforcimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për zbatimin e aktiviteteve të caktuara të komunës në kuadër të Programit për mundësi të barabarta (krijimi i një dialogu dhe drejtimi i organizatave të shoqërisë civile drejt zhvillimit të projekteve që janë në interes të komunës).
**6.** Me qëllim që të sigurohet një vazhdimësi në punën e Komisionit për mundësi të barabarta, 20% e këshilltarëve të këtij Komisioni të jenë nga përbërja e mëparshme.

**IN MEMORIAM**

**Сочувство за загубата на нашиот драг Градоначалник, Ружди Љата**

Тегобно е кога токму загубата на еден човечки живот е потсетник за неговата големина. Градоначалникот Ружди Љата беше навистина голем човек, добар домаќин и татко на сите граѓани во Општина Дебар. Кој ја почувствувал неговата длабока духовна сила, вечно ќе го памети. А, ќе се паметат и неговите дела, што тој ги направеше како Градоначалник. Смртта на Љата е ненадоместлива за неговото семејство но, и за сите граѓани во општината и во Република Македонија. Станува збор за успешен градоначалник, кој беше целосно посветен на развој на сопствената општина и на развој на децентрализацијата на власта и на демократските процеси во земјава.
ЗЕЛС загуби човек, кој со својата сила и искуства претставуваше силна потпора за нејзин континуиран развој и поборник за мирно решавање на сите предизвици со кои се соочувавме. Неговите успеси ги потврдуваат не само сограѓаните од општина Дебар, туку тие беа длабоко почитувани и применувани од другите општини во земјава и надвор од неа. ЗЕЛС упатува искрено жалење за огромната загуба пред се до неговото семејство, како и до вработените во општина Дебар и до членовите на Советот.
Почивај во мир, наш драг Градоначалник !

**Од ЗЕЛС**



**IN MEMORIAM**

**Ngushëllime për humbjen e kryetarit tonë të dashur, Ruzhdi Lata**

Është trishtuese kur humbja e një jete njeriu është përkujtues për madhështinë e tij. Kryetari Ruzhdi Lata ishte vërtetë njeri i madh, familjar i mirë dhe baba i të gjithë qytetarëve të Komunës së Dibrës. Kush ka pasur mundësi të ndjejë forcën e tij të thellë shpirtërore, përjetësisht do ta mbajë mend. Dhe do mbahen mend edhe veprat e tij të cilat i la si Kryetar i komunës. Humbja e kryetarit Lata është e pazëvendësueshme për familjen e tij dhe e tillë është edhe për të gjithë qytetarët e komunës dhe për Republikën e Maqedonisë. Bëhet fjalë për kryetar shumë të suksesshëm, i cili ishte shumë i përkushtuar jo vetëm ndaj zhvillimit të komunës së Dibrës, por edhe zhvillimit të decentralizimit të pushtetit dhe proceseve demokratike në vend.
BNJVL humbi një njeri, i cili me forcën e tij dhe përvojën e tij përfaqësonte mbështetje të fuqishme për zhvillimin e saj të pandërprerë, por edhe zotues për zgjidhjen e qetë të të gjitha sfidave me të cilat përballeshim. Sukseset e tij i vërtetojnë jo vetëm qytetarët e komunës së Dibrës, por ato janë shumë të respektuara dhe të aplikuara edhe nga komunat e tjera në vend dhe jashtë vendit. BNJVL shpreh ngushëllimet e sinqerta për humbjen e madhe para së gjithash deri te familja e tij, administrata komunale dhe deri te këshilltarët e komunës së Dibrës.
Prehu në paqe, Kryetari ynë i dashur!

**Nga BNJVL**

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVEISJES LOKALE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË




**КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ**
тел. +389 (0)2 30 99 033 | факс: +389 (0)2 30 61 994
ул. "Копенхагенска" бр. 5, п. фах 32, 1000 Скопје, Република Македонија
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

**INFORMACIONE PËR KONTAKT:**
tel. +389 (0)2 30 99 033 | faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. "Kopenhagenska" nr. 5, F.P. фах 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk